



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 72, datë 7.10.2016

Për

“MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR DHËNIEN ME QIRA TË FUSHËS SË SPORTIT NË FSHATIN MËZEZ, NJËSIA ADMINISTRATIVE KASHAR, ME NR.PASURIE 191/3 ME SIPËRFAQE TOTALE 7680 M²”.

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “b” dhe pika 1/1.2, nenit 25, nenit 54, shkronja “e”, nenit 55, pikat 4 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore”; Ligjit nr. 115/2014, datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 645, datë 31.07.2013 për “Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Kashar, të Qarkut të Tiranës”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 05.02.2014 për “Përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” (i ndryshuar); Udhëzimit nr. 6756, datë 03.09.2015 për “Zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

V E N D O S I:

1. Miratimin e propozimit për dhënie me qira të fushës së sportit në fshatin Mëzez, Njësia Administrative Kashar, me nr.pasurie 191/3, zona kadastrale 2679, volum 32 faqe 208 lloji i pasurisë “P.F” me sipërfaqe totale 7680 m², sipas genplanit bashkëlidhur”.
2. Ky proces të kryhet nëpërmjet procedurave të konkurimit publik dhe elementëve të tij në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 05.02.2014 për “Përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” (i ndryshuar).

3. T'i dërgohet dosja me propozimet përkatëse Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes si përfaqësues i pronarit të pronës publike për kryerjen e procedurave të mëtejshme për lidhjen e kontratës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për "Vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI